

UDHËZIM
Nr. 4, datë 11.4.2014

**PËR PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 26.03.2014, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, pika 8,

UDHËZOJMË:

I. Të përgjithshme

1. Nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2014 për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, zëri “Transferte në buxhetet familjare” të përdoret për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.

2. Fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural do të mbështetë:

- a) grumbullimin e frutave dhe perimeve;
- b) prodhimin e produkteve organike;
- c) prodhimin e rrushit dhe bimëve medicinale;
- d) prodhimin e perimeve në mjedise të mbrojtura;
- e) mbrojtjen e ullishteve nga dëmtimi prej mizës së ullirit;
- f) mbarështimin e gjedhit dhe bagëtive të imta;
- g) prodhimin e produkteve blegtorale;
- h) prodhimin e mjaltit;
- i) prodhimin e sektorit të akuakulturës;
- j) nxitjen e kreditimit bankar dhe investimeve në sektorin e bujqësisë.

3. Masat e mbështetjes dhe masa e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në shkallë vendi, të jenë, si më poshtë vijon:

1) Mbështetjen për dorëzimin e prodhimit të frutave dhe perimeve në pikat e grumbullimit ose përpunimit, në masën 15% të vlerës së mallit të shitur dhe të vërtetuar me faturë tatimore, për jo më pak se 30 (tridhjetë) kv dhe jo më shumë se 300 (treqind) kv, për frutat, dhe për jo më pak se 50 (pesëdhjetë) kv dhe jo më shumë se 400 (katërqind) kv, për perimet;

2) Mbështetjen e fermave organike, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë/fermë të certifikuar;

3) Përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes dhe kultivimit të vreshtave me fidanë të kultivarëve autoktonë, në vlerën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë/ha dhe me fidanë të kultivarëve të tjerë, në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha për sipërfaqe jo më të vogël se 0.2 ha dhe jo më të madhe se 10 ha;

4) Përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes dhe kultivimit të bimëve medicinale të kultivuara, si: sherbelë, lavanda, timus, rigon, rozmarinë, mëllagë e bardhë, tërfili i kuq dhe kokoçeli (lule ciani), në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha për sipërfaqe jo më të vogël se 0.2 ha dhe jo më të madhe se 10 ha;

5) Mbështetja e prodhimit në serra me ngrohje qendrore përmes financimit, në masën 50 % të koston të lëndës djegëse, të vërtetuar me faturë tatimore të shoqëruar me kuponin e kasës fiskale ose me urdhër xhirimi të bankës;

6) Ujitja me pika në ullishte, vreshta, pemëtore, agrume, (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre), në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, por financimi të bëhet për jo më pak se 0,5 ha dhe jo më shumë se 10 ha;

7) Rehabilitimi i blloqeve të ullishteve ekzistuese të vjetra dhe/ose të degraduara, në masën 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 300 (treqind) ha në shkallë vendi;

8) Mbrojtja e ullishteve nga dëmtimi prej mizës së ullirit, në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit, në vlerën jo më shumë se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë/ha;

9) Mbështetja e prodhimit të qumështit me 10 (dhjetë) lekë/litër për fermat blegtorale që dorëzojnë minimalisht 1,500 litra qumësht në muaj, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për fermë në muaj. Pagesa të bëhet kundrejt sasive të qumështit të shitura me faturë tatimore;

10) Mbështetja e fermave blegtorale që mbarështojnë në mënyrë ekstensive (regjim gjysmëstallor) lopë të matrikulluara në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por financimi të bëhet për jo më pak se 10 (dhjetë) krerë dhe jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë;

11) Mbështetja e fermave blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele ose dhi të matrikulluara, në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 300 (treqind) krerë;

12) Mbështetja e mishit të të imtave, në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë të matrikulluar, për çdo therje në thertore, dhe 100 (njëqind) lekë, për lëkurën e dorëzuar në fabrikën e përpunimit në vend;

13) Mbështetja e mishit të derrit, në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë të matrikulluar, për çdo therje në thertore, dhe 100 (njëqind) lekë, për lëkurën e dorëzuar në fabrikën e përpunimit në vend;

14) Mbështetja e mishit të gjedhit, në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë/krerë të matrikulluar, për çdo therje në thertore, dhe 200 (dyqind) lekë, për lëkurën e dorëzuar në fabrikën e përpunimit në vend;

15) Mbështetja për bletë rritësit me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere bletë, në vlerën 1 000 (një mijë) lekë/koshere;

16) Mbarështimi intensiv i kërmillit, në masën 50% të vlerës së rasatit deri 500 (pesëqind) kg/ha, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha. Kjo mbështetje të jetë për ata që fillojnë investimin për mbarështimin e kërmillit për herë të parë. Për mbarështuesit, që e kanë bërë investimin fillestar më parë, të mbështeten fermat që bëjnë mbarështimin intensiv të kërmillit, me një vlerë 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha;

17) Mbështetja e sektorit të akuakulturës, në masën 25% të vlerës së rasatit, por jo më shumë se 600 (gjashtëqind) mijë lekë/fermë dhe 25% të vlerës së ushqimeve për peshkun nën kultivim, por jo më shumë se 500 (pesëqind) mijë lekë/fermë, vërtetuar me faturë tatimore të shoqëruar me kuponin e kasës fiskale ose me urdhër xhirimi të bankës;

18) Mbështetja për dorëzimin e prodhimit të midhjeve në qendrat e grumbullimit dhe/përpunimit, në vlerën 10 (dhjetë) lekë/kg të dorëzuar (të shitur) e të vërtetuar me faturë tatimore, por financimi të bëhet për jo më pak se 200 (dyqind) kv dhe jo më shumë se 1 000 (një mijë) kv në vit;

19) Mbështetja, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 7 (shtatë) vite radhazi, për kreditë deri në 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtme:

- Ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe bimëve medicinale;
- Mekanizimin e bujqësisë, blegtorisë dhe akuakulturës.

20) Mbështetja e investimeve deri në 50% të vlerës së projektit, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për një subjekt, për:

- ngritje ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit;
- linja për standardizim dhe/ose përpunim prodhimi;
- mekanikë bujqësore;
- hapje pusesh, rezervuarësh për vaditje dhe lerash.

4. Vlera prej 154 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë) lekësh do të përdoret për bashkëfinancim me projektin IPA, 2011, “Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

5. Këto fonde do të zbatohen sipas marrëveshjes operationale të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, AZHBR-së dhe projektit GIZ.

6. Për informacionin mediatik të publikut lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2014, të përdoret nga ky fond vlera prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh.

7. Financimi i masës mbështetëse për prodhimin në serra me ngrohje qendrore, sipas rastit, të bëhet edhe në tremujorin e parë të vitit pasardhës, me fondet e caktuara për vitin përkatës buxhetor, por gjithnjë sipas masës së përfitimit të përcaktuar për vitin 2014.

SHKURTIME

MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit dhe Rural Administrimit të Ujërave
MF	Ministria e Financave
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
DB	Drejtoria e Bujqësisë
ZBRR	Zyra e Bujqësisë në Rreth
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
DPAP	Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve
DK	Drejtoria e Kontrollit

KRITERET PËR TË PËRFITUAR MBËSHTETJE, PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES, VERIFIKIMIT DHE PAGESËS

1. Mbështetjen për dorëzimin e prodhimit të frutave dhe perimeve në pikat e grumbullimit ose përpunimit, në masën 15% të vlerës së mallit të shitur dhe të vërtetuar me faturë tatimore, për jo më pak se 30 (tridhjetë) kv dhe jo më shumë se 300 (treqind) kv, për frutat, dhe për jo më pak se 50 (pesëdhjetë) kv dhe jo më shumë se 400 (katërqind) kv, për perimet.

1.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë, subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor.

b) Paga të bëhet vetëm kundrejt sasive të frutave dhe perimeve (aneksi 1) të shitura me faturë tatimore, në pikat e grumbullimit ose përpunimit që janë të regjistruara në organet tatimore;

c) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”;

1.2 KRITERET KONKURRESE

- | | |
|------------------------------------|-----------|
| 1. Sasia e prodhimit e planifikuar | 60 pikë; |
| 2. Produkte BIO | 15 pikë; |
| 3. Statusi i aplikantit | 15 pikë; |
| 4. Aplikante femër | 5 pikë; |
| 5. Aplikant nën moshën 40 vjeç | 5 pikë; |
| TOTALI | 100 pikë; |

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë, nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Paga të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

1.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Perioda e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 2 maj deri 30 maj 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 1/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike të aplikantit;
 - b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;
 - c) Formular me të dhënat kryesore të aktivitetit sipas formatit bashkëngjitur;
 - d) Certifikatën BIO ose në kalim (konvertim), të lëshuar nga organizmi certifikues për produktin/produktet e fermës së tij;
 - e) Dokumenti i pronësisë, përdorim ose marrjes së tokës me qira;
 - f) Vërtetimi nga komuna/bashkia, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2014;
 - g) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë.
- Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtme:
- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;
 - Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;
 - Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- a) Kontratë qiraje me individë;
- b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip).

Kontrata e qirasë në të dyja rastet bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Aplikimi, së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 1/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 1/4). Një kopje të formularit 1/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t’i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 1/4).

DB-ja grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kriterëve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR-ja.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB – anëtar.

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBR-së bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër. Listat e vlerësuara dhe

të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 1/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 1/7).

Të dy formularët (1/6 dhe 1/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

Për sasinë e prodhimit të planifikuar në dorëzimin e frutave: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- | | |
|-----------------|----------|
| a) 201 – 300 kv | 60 pikë; |
| b) 101 – 200 kv | 57 pikë; |
| c) 30 – 100 kv | 55 pikë. |

Për sasinë e prodhimit të planifikuar në dorëzimin e perimeve: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- | | |
|-----------------|----------|
| a) 251 – 400 kv | 60 pikë; |
| b) 151 – 250 kv | 57 pikë; |
| c) 50 – 150 kv | 55 pikë. |

Për statusin e aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- | | |
|---|----------|
| a) Aplikanti individual | 5 pikë; |
| b) Subjekte me status fizik ose juridik | 10 pikë; |
| c) Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor | 15 pikë. |

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR-Qendër.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja rajonale organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij ligjor, bën verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit (formulari 1/8). Nga ballafaqimi i faktit (toka duhet të jetë e mbjellë me kultura sipas projektit) me kriteret e përfitueshmërisë, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse realizimi i aplikimit të fermerit është në përputhje me udhëzimin dhe kriteret e përfitimit.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast, aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e

nevojshme dhe të firmosë për to.

Verifikimi kryhet pas njoftimit që fermeri i bënë inspektorëve të AZHBR-së në qark për realizimin e projektit.

Verifikimi për projektet do të bëhet në periudhën e vegjetacionit sipas kulturave të parashikuara në projekt.

Grupi i verifikimit bën vlerësim të përputhshmërisë së projektit me faktin dhe plotëson formularin e verifikimit.

Fermeri dorëzon tek inspektorët e AZHBR-së, faturat e shitjes së prodhimit/prodhimeve. Fatura duhet të jetë:

1. Për subjektet, faturë tatimore e shitjes e shoqëruar me kuponin e kasës fiskale;
2. Për fermerët individual, faturë tatimore për fermerin (autofaturë).

Fatura/faturat, që dorëzohen të parat nuk pranohen për një sasi prodhimi më të vogël se minimumi i parashikuar në masën mbështetëse. Inspektorët plotësojnë formularin e marrjes në dorëzim të faturave (formulari 1/8/b).

Së bashku me faturat aplikanti dorëzon:

Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit, ose vërtetim pensioni nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 1/8) në AZHBR.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR-Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 1/9 dhe 1/9/a).

AZHBR pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë.

Në rast të mosplotësimit të kriterëve, aplikimi skualifikohet dhe dosja arkivohet.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR-së, sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme.

2. Mbështetjen e fermave organike, në vlerën 80, 000 (tetëdhjetë mijë) lekë/fermë të certifikuar.

2.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë ose subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor.

b) Përfitojnë të gjithë ata fermerë apo subjekte që kanë ferma të certifikuara për prodhim BIO, me kusht që sipërfaqja e një specie të mos jetë më e vogël se 0.5 ha;

c) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim ose me qira për të paktën 5 vjet;

d) Të kenë kontratë me subjektet tregtuese dhe agropërpunues për produktin e certifikuar;

e) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2014;

f) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

2.2 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 2 maj deri 30 shtator 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR, sipas formularit të aplikimit (formulari 2/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike së aplikantit;
- b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;

c) Formulari me të dhënat kryesore të fermës (formulari 2/2);

d) Certifikatën BIO ose në kalim (konvertim), të lëshuar nga organizmi certifikues për produktin/produktet e fermës së tij;

e) Kontratë e noterizuar me subjekte tregtues ose agropërpunues për produktin e certifikuar në të cilën shënohet që “Produkti është BIO”;

f) Dokumenti i pronësisë/marrjes së tokës me qira;

g) Vërtetimi nga komuna/bashkia, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2014;

h) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë;

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

- Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

a) Kontratë qiraje me individë;

b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip);

Kontrata e qirasë në të dyja rastet, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 2/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 2/4). Një kopje të formularit 2/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 2/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

Një kopje e listave të aplikantëve të renditur sipas parimit “kush vjen i pari, renditet i pari”, me firmë dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Me marrjen e të gjithë listave dhe dokumentacionit, DB-të bëjnë transferimin e dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-qark, sipas formularit 2/7.

Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në regjistrin e aplikantëve të rrethit. Për çdo dosje të dorëzuar plotësohet formulari i dorëzimit të dosjes (formulari 2/6).

Të dy formularët (2/6 dhe 2/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB-së, në rolin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR-së në rolin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR - së. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara në AZHBR-Qark.

B. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR-së bëhet edhe hedhja në *data base* i aplikimeve të

vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR-qendër.

C. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve sipas radhës “Kush vjen i pari, renditet i pari”, dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR rajonale organizon verifikimin në terren të aplikimeve që kanë fituar të drejtën e financimit.

Për verifikimin e fermave BIO dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij ligjor, bën verifikimin në vend të fermës dhe plotëson formularin e verifikimit (formulari 2/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë, si dhe me të dhënat e deklaruara në formularin 2/2, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse aplikimi është në përputhje me udhëzimin.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë ekipi i verifikimit të projekteve.

Për çdo rast, aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit, aplikanti duhet të paraqesë:

a) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit.

Grupi i verifikimit, brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit, dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (Formulari 2/8) në AZHBR-Qendër.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR-qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 2/9 dhe 2/9/a).

AZHBR-ja pas kontrollit administrativ të dokumentacionit, bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë.

Në rast të mosplotësimit të kriterëve, aplikimi skualifikohet dhe dosja arkivohet.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR, sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme.

3. Përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes dhe kultivimit të vreshtave me fidanë të kultivarëve autoktonë, në vlerën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë/ha dhe me fidanë të kultivarëve të tjerë, në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha për sipërfaqe jo më të vogël se 0.2 ha dhe jo më të madhe se 10 ha.

3.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

b) Ngritja e vreshtave të bëhet në zona të studiuara në përputhje me rajonizimin e varieteteve të përcaktuara për secilin qark në aneksin nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

c) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym;

d) Të ketë të paktën numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me aneksin nr. 3, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

e) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim dhe/ose me qira për të paktën 20 vjet nga viti i aplikimit;

f) Aplikanti mund të bëjë më shumë se një aplikim (kur toka nuk ndodhet në të njëjtin vend, kur aplikon për kultivar të ndryshëm (autokton dhe të tjerë) dhe destinacione të ndryshme të prodhimit), por çdo aplikim duhet të plotësojë kriterin minimal të sipërfaqes dhe totali i sipërfaqes maksimale për çdo aplikant nuk duhet të jetë më shumë se 10 ha;

g) Përfitojnë vetëm aplikantët për mbjellje të reja të vitit 2014;

h) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2014;

i) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

3.2 KRITERET KONKURRUESE

1. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet 40 pikë;

2. Kultivarë autoktonë 5 pikë;

3. Shtim i sipërfaqes në bllok për specien që aplikon 5 pikë;

4. Statusi i aplikantit 15 pikë;

5. Aplikante femër 5 pikë;

6. Aplikant nën moshën 40 vjeç 5 pikë;

7. Teknika e projektuar për ngritjen e vreshtit 25 pikë;

TOTALI 100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

3.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periodha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 2 maj deri 30 maj 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 3/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike të aplikantit;

b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;

c) Projekti (formulari 3/2);

d) Dokumenti i pronësisë, përdorimit ose marrjes së tokës me qira;

e) Vërtetimi nga komuna/bashkia, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2014;

f) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë;

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtme:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

- Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

a) Kontratë qiraje me individë;

b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip);

Kontrata e qirasë në të dyja rastet, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e

aplikantit në formularin e pranimit (formulari 3/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 3/4). Një kopje të formularit 3/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 3/4).

DB grumbullon listat e ZBR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kriterëve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR.

Në çdo DB ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh, sipas formularit përkatës (formulari 3/5), i cili duhet të jetë firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen që do të mbillet e fiton aplikimi me sipërfaqen maksimale të pranueshme, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këtë sipërfaqe.

Për statusin e aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë;

- | | |
|---|----------|
| a) Aplikanti individual | 5 pikë; |
| b) Subjekte me status fizik ose juridik | 10 pikë; |
| c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor | 15 pikë. |

Teknika e projektuar për ngritjen e vreshtit:

- | | |
|-------------------------------|----------|
| a) Sistemimi/punimi i tokës | 15 pikë; |
| b) Masat antierozive/kulluese | 5 pikë; |
| c) Sistemi ujitjes me pika | 5 pikë. |

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR-së bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 3/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 3/7).

Të dy formularët (3/6 dhe 3/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB-së, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark.

DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR-së bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuar. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i verifikimit të projekteve", i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është ndërtimi i vreshtave, sipas projektit për të cilën fermeri ka aplikuar dhe është vlerësuar.

Menjëherë pas përfundimit të punës për ngritjen e vreshtave, fermeri njofton AZHBR-në. Kjo e fundit dërgon grupin e verifikimit të projekteve për verifikimin në vend të realizimit të projektit, duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi, bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (formulari 3/8). Nga ballafaqimi i faktit me udhëzimin dhe parametrat e projektit, në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me projektin e miratuar dhe kriteret e përfitueshmërisë.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën tatimore të blerjes së fidanëve, ku specifikohet sasia e fidanëve të blerë;
- Një kopje të certifikatës së garancisë së materialit mbjellës (fidanit), me vulën origjinale (të njomë);
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit, lidhur me shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 3/8) në AZHBR-Qendër.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR-Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 3/9 dhe 3/9/a).

AZHBR-ja, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë.

Në rast të mosplotësimit të kriterëve, aplikimi skualifikohet dhe dosja arkivohet.

Financimi për mbjelljen e vreshtave do të bëhet në dy këste: 70% të vlerës së projektit financohet pas verifikimit të parë dhe 30 % të vlerës së projektit bëhet gjatë muajve tetor/nëntor 2014.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes, në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton deri në 10%, aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar;
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10%, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike;

- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 40%, aplikanti skualifikohet.

Pas financimit të kështit të parë dhe para financimit të kështit të dytë (30% e vlerës së financimit), AZHBR-Qendër rikontrollon, jo më pak se 10% të projekteve të financuara. Rikontrolli i projekteve nuk do të bëhet nga i njëjti ekip, që ka realizuar verifikimin e parë.

Gjatë kontrollit pas financimit, grupi i kontrollit krahas ballafaqimit të rezultateve të verifikimit para financimit me faktin, do të verifikojë edhe përqindjen e zënies së fidanëve, zhvillimin i tyre dhe nivelin e shërbimeve agroteknike (formulari 3/8/a).

Nëse investimi i rikontrolluar ka probleme si rezultat i mungesës së shërbimeve agroteknike, si infeksione të larta nga barërat e këqija, përqindje të fidanëve të dëmtuar mbi 10%, aplikantëve nuk do t'u financohet kësti i dytë.

Nëse në projektet e kontrolluara pas financimit ka ndryshime të parametrave sasiore, të cilat ndikojnë në vlerën financiare që përfituesi ka përfituar padrejtësisht, AZHBR-ja bën rillogaritjet dhe propozon masat përkatëse.

4. Përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes dhe kultivimit të bimëve medicinale të kultivuara, si: sherbelë, lavanda, timus, rigon, rozmarinë, mëllagë e bardhë, tërfili i kuq dhe kocoçeli (lule ciani), në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha për sipërfaqe jo më të vogël se 0.2 ha dhe jo më të madhe se 10 ha.

4.1 KRITERET E PËRFTIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

b) Speciet që parashikohen në projekt duhet të jenë brenda listës së përcaktuar në aneksin 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi;

c) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 2 dynym dhe sipërfaqja maksimale jo më e madhe se 10 ha;

d) Të ketë numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me aneksin nr. 3, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

e) Toka të jetë në pronësi, në përdorim dhe/ose me qira, për të paktën 5 vjet nga viti i aplikimit;

f) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2014;

g) Përfitojnë vetëm aplikantët për mbjellje të reja të vitit 2014;

h) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

4.2 KRITERE KONKURRUESE

1. Sipërfaqja e tokës që do të mbillet	40 pikë;
2. Specia sipas rajonizimit	10 pikë;
3. Kultivarë autoktonë	5 pikë;
4. Statusi i aplikantit	15 pikë;
5. Aplikante femër	5 pikë;
6. Aplikant nën moshën 40 vjeç	5 pikë;
7. Teknologjia e kultivimit	20 pikë;
TOTALI	100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

4.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 2 maj deri më 30 maj 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 4/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e

aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike të aplikantit;
- b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;
- c) Projekti (formulari 4/2);
- d) Dokumenti i pronësisë, përdorimit ose marrjes së tokës me qira;
- e) Vërtetimi nga komuna/bashkia, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2014;
- f) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtme:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

- Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- a) Kontratë qiraje me individë;
- b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip);

Kontrata e qirasë në të dyja rastet, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 4/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 4/4). Një kopje të formularit 3/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 4/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kritereve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh, sipas formularit përkatës (formulari 4/5), i cili duhet të jetë i firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen që do të mbillet e fiton aplikimi me sipërfaqen maksimale të pranueshme, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këtë sipërfaqe.

Specia sipas rajonizimit (aneksi 4): Pikët maksimale 10 i marrin speciet prioritare dhe gradualisht pikët minimale 5 pikë i marrin speciet më pak prioritare. Prioritetet përcaktohen nga DB.

Statusi i aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a) Aplikanti individual 5 pikë;
- b) Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë;
- c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor 15 pikë.

Teknologjike e kultivimit:

- a) Sistemimi/punimi i tokës 15 pikë;
- b) Masat antierozive/kullues 5 pikë.

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 4/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 4/7).

Të dy formularët (4/6 dhe 4/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB-së, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i verifikimit të projekteve", i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është mbjellja e sipërfaqeve me bimë medicinale, sipas projektit për të cilën fermeri ka aplikuar dhe është vlerësuar.

Menjëherë pas përfundimit të punës, fermeri njofton AZHBR-në. Kjo e fundit dërgon grupin e verifikimit të projekteve për verifikimin në vend të realizimit të projektit, duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi, bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (formulari 4/8). Nga ballafaqimi i faktit me udhëzimin dhe parametrat e projektit, në bazë të të cilit, aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me projektin e miratuar dhe kriteret e përfitueshmërisë.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën tatimore të blerjes së fidanëve, ku specifikohet sasia dhe lloji i fidanëve të blerë;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit, lidhur me shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 4/8) në AZHBR-Qendër.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR-Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 4/9 dhe 4/9/a).

AZHBR-ja, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit, bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë.

Në rast të mosplotësimit të kriterëve, aplikimi skualifikohet dhe dosja arkivohet.

Financimi për mbjelljen e bimëve medicinale do të bëhet në dy këste: 70% të vlerës së projektit financohet pas verifikimit të parë dhe 30 % të vlerës së projektit bëhet gjatë muajve tetor/nëntor 2014.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes, në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton deri në 10%, aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar;
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10%, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike;
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 40%, aplikanti skualifikohet.

Pas financimit të kështit të parë dhe para financimit të kështit të dytë (30% e vlerës së financimit), AZHBR-Qendër rikontrollon, jo më pak se 10% të projekteve të financuara. Rikontrolli i projekteve nuk do të bëhet nga i njëjti ekip, që ka realizuar verifikimin e parë.

Gjatë kontrollit pas financimit, grupi i kontrollit krahas ballafaqimit të rezultateve të verifikimit para financimit me faktin, do të verifikojë edhe përqindjen e zënies së fidanëve, zhvillimin i tyre dhe nivelin e shërbimeve agroteknike (formulari 4/8/a).

Nëse investimi i rikontrolluar ka probleme si rezultat i mungesës së shërbimeve agroteknike, si infeksione të larta nga barërat e këqija, përqindje të fidanëve të dëmtuar mbi 10%, aplikantëve nuk do t'u financohet kështi i dytë.

Nëse në projektet e kontrolluara pas financimit ka ndryshime të parametrave sasiore, të cilat ndikojnë në vlerën financiare që përfituesi ka përfituar padrejtësisht, AZHBR-ja bën rillogaritjet dhe propozon masat përkatëse.

5. Mbështetja e prodhimit në serra me ngrohje qendrore përmes financimit, në masën 50% të kostos së lëndës djegëse, të vërtetuar me faturë tatimore të shoqëruar me kuponin e kasës fiskale ose me urdhër xhirimi të bankës.

5.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Subjekt me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

b) Fermerët që kanë serra me ngrohje qendrore (naftë ose solar), me destinacion prodhimin e perimeve;

c) Vlera e përfitimit do të jetë 50% e vlerës së faturës, por jo më shumë se 100 mijë lekë/ dy, për ngrohje të serës me naftë dhe 80 mijë lekë/dy, për ngrohjen me solar, për të gjithë periudhën e

ngrohjes (dhjetor-shkurt);

- d) Financimi të jetë për serra me sipërfaqe, jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë se 2 ha;
- e) Serra të jetë e mbjellë në momentin e verifikimit;
- f) Serra të ketë të montuar dhe funksional sistemin e ngrohjes;
- g) Kapaciteti i kaldajës të plotësojë kërkesat e parametrave të serës;
- h) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2014;
- i) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

5.2 KRITERET KONKURRUESE

1. Sipërfaqja e serrës	40 pikë;
2. Tipi i serrës	30 pikë;
3. Statusi i aplikantit	15 pikë;
4. Prodhim BIO	5 pikë;
5. Aplikante femër	5 pikë;
6. Aplikant nën moshën 40 vjeç	5 pikë;
TOTALI	100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

5.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 1 shtator deri 31 tetor 2014.

Mbjelljet e para të lejuara për aplikim janë kulturat (domate, kastravec, spec, patëllxhan, pjepër, kungull gjelle, barbutë), ndërsa mbjelljet e dyta të lejuara janë kulturat (domate, kastravec, spec).

Fermerët individualë, subjekte apo SHBB aplikojnë për të përfituar mbështetje financiare para fillimit të punës për përdorimin e lëndës djegëse.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 5/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike e aplikantit;
- b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;
- c) Projekti (formularit 5/2);
- d) Certifikatën BIO ose në kalim (konvertim), të lëshuar nga organizmi certifikues për produktin/produktet e fermës së tij;
- e) Dokumenti i pronësisë, përdorimit ose marrjes së tokës me qira;
- f) Vërtetimi nga komuna/bashkia, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2014;
- g) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”;
- h) Vërtetim banke për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

- Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- a) Kontratë qiraje me individë;
- b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip);

Kontrata e qirasë në të dyja rastet, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë

bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Aplikimi, së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 5/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 5/4). Një kopje të formularit 5/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 5/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kriterëve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR-ja.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialistë të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (formulari 5/5).

Vlerësimi maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqen më të madhe, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Vlerësimin maksimal për tipin e serrës e marrin serrat me konstruksion metalik (xingato).

Statusi i aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë;

- | | |
|---|----------|
| a) Aplikanti individual | 5 pikë; |
| b) Subjekte me status fizik ose juridik | 10 pikë; |
| c) Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor | 15 pikë. |

Produkti BIO: Aplikanti duhet të paraqesë në momentin e aplikimit certifikatën BIO ose në kalim (konvertim), të lëshuar nga organizmi certifikues për produktin/produktet e fermës së tij.

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR-së bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 5/6), dhe regjistrin e dorëzimit në

AZHBR-Qark (formulari 5/7).

Të dy formularët (5/6 dhe 5/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR-së, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuar. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve, në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-Qark organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Kushti i domosdoshëm për të përfutur mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është kultivimi i serrave me speciet e deklaruara në aplikim.

Në momentin e verifikimit, fidani të jetë i mbjellë në serë për kulturat e para, ndërsa kulturat e dyta të jetë në prodhim. Pas përfundimit të mbjelljes së kulturave për mbjelljet e para dhe kur bima është në prodhim për kulturat e dyta, fermeri kërkon grupin e verifikimit për kontroll në terren. AZHBR-ja dërgon grupin e verifikimit të projekteve, për verifikim në vend të projektit, duke lajmëruar paraprakisht aplikantin ose përfaqësuesin e tij ligjor, për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi ligjor, bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (formulari 5/8). Verifikimi përfshin edhe funksionalitetin e kaldajës, kushtet teknike dhe specifikimet e nevojshme të kaldajës.

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e projektit, në bazë të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast, aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Deri në javën e parë të muajit mars 2015, aplikanti duhet t’i dorëzojë inspektorëve të AZHBR-së në Qark, faturën tatimore me TVSH, e shoqëruar me kuponin tatimor të kasës fiskale ose me urdhër xhirimin e bankës.

Verifikimi dhe pagesa

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga dorëzimi i faturave (formulari 5/8/b), dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 5/8) në AZHBR-Qendër.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në drejtoritë përkatëse të AZHBR, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 5/9 dhe 5/9a).

AZHBR-Qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit, në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumenteve të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në DPAP me argumentin përkatës (formulari 5/9/a).

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes, në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton deri në 10%, aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar;

- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10%, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike;

- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 40%, aplikanti skualifikohet.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR-Qendër, sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR.

6. Ujitja me pika në ullishte, vreshta, pemëtore, agrume (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre), në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, por financimi të bëhet për jo më pak se 0,5 ha dhe jo më shumë se 10 ha.

6.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë, grup fermerësh dhe subjekte me status fizik ose juridik;

- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

b) Sipërfaqja minimale për të cilën aplikohet të jetë jo më e vogël se 5 dynym dhe jo më e madhe se 10 ha;

c) Speciet që parashikohen në projekt të ketë numrin minimal të bimëve për njësi sipërfaqe në përputhje me aneksin nr. 3, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

d) Aplikanti mund të bëjë një aplikim për të njëjtën specie ose për specie të ndryshme, por toka për të cilën aplikohet të jetë një parcelë, bllok dhe mënyra e kultivimit intensive;

e) Tubacioni kryesor i furnizimit të sistemit shpërndarës të jetë i vendosur nën tokë;

f) Toka të jetë në pronësi të aplikantit, në përdorim dhe/ose me qira për të paktën 20 vjet nga momenti aplikimit;

g) Përfituesi të ketë paguar taksën e tokës për vitin 2014;

h) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

6.2 KRITERET KONKURRUESE

1. Sipërfaqja e tokës	40 pikë;
2. Teknika e projektuar për ujitjen	20 pikë;
3. Statusi i aplikantit	15 pikë;
4. Specie/speciet	10 pikë;
5. Fermat BIO	5 pikë;
6. Aplikante femër	5 pikë;
7. Aplikant nën 40 vjeç	5 pikë;
TOTALI	100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

6.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 2 maj – 30 maj 2014.

Aplikimet për këtë skemë duhet të dorëzohen para fillimit të punës për instalimin e sistemit të ujitjes me pika.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 6/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike së aplikantit;

b) Prokurë e posaçme në emër të aplikantit, në rastet kur aplikojnë grup fermerësh. Bashkëlidhur të paraqiten dokumentet e pronësisë dhe vërtetimet e pagesës së taksës së tokës;

c) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;

d) Projekti (Formulari 6/2);

e) Certifikatën BIO ose në kalim (konvertim), lëshuar nga organizmi certifikues për produktin/produktet e fermës së tij;

f) Dokumenti i pronësisë, përdorimit ose marrjes së tokës me qira;

g) Vërtetimi nga komuna/bashkia, që vërteton pagesën e taksës së tokës për vitin 2014;

h) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

- Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

a) Kontratë qiraje me individë;

b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip).

Kontrata e qirasë në të dyja rastet, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Për grupet e fermerëve aplikanti plotëson dosjen e aplikimit me të gjithë dokumentacionin përkatës të njëjta si për fermerët individualë me përjashtim të projektit që do të jetë i përbashkët. Grupet e fermerëve caktojnë me prokurë e posaçme për personin përgjegjës për të aplikuar dhe ndjekur të gjitha procedurat e implementimit të projektit të aplikuar.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 6/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 6/4). Një kopje të formularit 6/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t’i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 6/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kriterëve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR-ja.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;

2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;

3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;

4. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (formulari 6/5).

Vlerësimi maksimal për sipërfaqen e fiton aplikuesi me sipërfaqen maksimale të aplikueshme, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me sipërfaqen më të madhe.

Për statusin e aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a) Aplikanti individual 5 pikë;
- b) Subjekte me status fizik/ juridik dhe grup fermerësh 10 pikë;
- c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor 15 pikë.

Specia sipas rajonizimit: Pikët maksimale 10 i marrin speciet prioritare dhe gradualisht pikët minimale 5 pikë e marrin speciet më pak prioritare. Prioritet përcaktohen nga DB. Secili qark do të bëjë një klasifikim të specieve/grup specieve sipas rëndësisë dhe vlerës ekonomike që kanë kulturat për qarkun dhe kërkesave të këtyre të fundit për ujë.

Teknika e projektuar për ujitjen: pikët maksimale i marrin aplikimet të cilët kanë projektuar hapjen e puseve me sonda, teknikat e tjera të sigurimit të ujit të nevojshëm për ujitje përfitojnë 15 pikë.

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (Formulari 6/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 6/7).

Të dy formularët (6/6 dhe 6/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR-së, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR-së bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Afati i fundit i verifikimit në terren do të jetë data 15 gusht 2014.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është instalimi dhe vënia në funksionim të sistemit të ujitjes me pika, sipas projektit për të cilën fermeri ka aplikuar dhe është vlerësuar.

Menjëherë pas përfundimit të punës për instalimin e sistemit të ujitjes me pika fermeri njofton AZHBR në rajon. Kjo e fundit dërgon grupin e verifikimit të projekteve për verifikimin në vend të realizimit të projektit duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij dhe disponibilitetin e dokumentacionit të kërkuar.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi ligjor, bën matjet dhe verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit të projektit (formulari 6/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e projektit, në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturat tatimore të blerjes për materialet e përdorura për instalimin e sistemit të ujitjes me pika;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit.

Grupi i verifikimit, brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit, dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 6/8) në AZHBR.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 6/9 dhe 6/9/a).

AZHBR-ja, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit, bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë së skemës mbështetëse.

Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumenteve të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë aplikimi skualifikohet dhe dosja arkivohet.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes, në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR-ja aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton deri në 10%, aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike pa u penalizuar;

- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10%, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të sipërfaqes faktike;

- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 40%, aplikanti skualifikohet.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR-Qendër, sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR-së.

Nëse në projektet e kontrolluara pas financimit ka ndryshime të parametrave sasiore të cilat ndikojnë në vlerën financiare që përfituesi ka përfituar padrejtësisht, AZHBR-ja bën rillogaritjet dhe propozon masat përkatëse.

7. Rehabilitimi i blloqeve të ullishteve ekzistuese të vjetra dhe/ose të degraduara, në masën 450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 300 (treqind) ha në shkallë vendi.

7.1 KRITERET E PËRFITIMIT

Përfitojnë fermerët që kanë ullinj në masivet e propozuara nga DB dhe të përzgjedhura nga MBZHRAU.

Rehabilitimi i ullishteve ekzistuese do të zbatohet në gjashtë blloqe pilot me sipërfaqe prej 50 ha secila, me prioritet zonat turistike, në rrethet: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Tiranë.

7.2 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Të përgjithshme

Rehabilitimi do të kryhet në blloqe me sipërfaqe jo më të vogla se 10 ha. Për blloqet që do të rehabilitohen, DB do të përcaktojë paraprakisht të dhënat e mëposhtme:

- Hartat kadastrale të blloqeve që do të trajtohen;
- Listën emërore të pronarëve dhe sipërfaqet përkatëse të ullishteve për të gjithë sipërfaqen që do të trajtohet;

- Fillimin dhe përfundimin e periudhës së rehabilitimit, për secilin bllok.

Dokumentet e mësipërme, duhet të dorëzohen në AZHBR-Qendër në rrugë protokollare brenda datës 15 maj 2014.

AZHBR, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike, do të shpallë kriteret dhe subjektet fituese që do të realizojnë shërbimin.

Subjekti/subjektet e përzgjedhur, në koordinim me pronarët e ullishteve, do të kryejnë procesin e rehabilitimit dhe në përfundim të tij do të njoftojnë dhe të dorëzojnë zyrtarisht në AZHBR, listën e plotë të pronarëve të ullishteve që janë rehabilituar.

B. Verifikimi dhe pagesa

AZHBR brenda 10 ditëve pune, nga marrja e njoftimit për përfundim të procesit të trajtimit, bënë verifikim në vend të punës së kryer.

Për verifikimin e realizimit të procesit të trajtimit dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve realizohet nga AZHBR-Qendër dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Grupi i verifikimit plotëson formularin e verifikimit (formulari 7/8). Formulari i verifikimit duhet të shoqërohet me listën e plotë të pronarëve të ullishteve të rehabilituara dhe i dërgon ato brenda 10 ditëve në AZHBR-Qendër.

AZHBR-Qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit, në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

8. Mbrojtja e ullishteve nga dëmtimi prej mizës së ullirit, në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit, në vlerën jo më shumë se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë/ha.

8.1 KRITERET E PËRFTIMIT

Përfitojnë fermerët që kanë ulla në masivet e propozuara nga DB dhe të përzgjedhura nga MBZHRAU.

8.2 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Të përgjithshme

Trajtimi do të kryhet në blloqe me sipërfaqe jo më të vogla se 50 ha. Për blloqet që do të trajtohen, DB do të përcaktojë paraprakisht të dhënat e mëposhtme:

- Hartat kadastrale të blloqeve që do të trajtohen;
- Listën emërore të pronarëve dhe sipërfaqet përkatëse të ullishteve për të gjithë sipërfaqen që do të trajtohet;

- Fillimin dhe përfundimin e periudhës së trajtimit, për secilin bllok.

Dokumentet e mësipërme, duhet të dorëzohen në AZHBR-Qendër, në rrugë protokollare brenda datës 15 maj 2014.

AZHBR-ja, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike, do të shpallë kriteret dhe subjektet fituese që do të realizojnë shërbimin.

Subjekti/subjektet e përzgjedhur, në koordinim me pronarët e ullishteve, do të kryejnë procesin e trajtimit dhe në përfundim të tij do të njoftojnë dhe të dorëzojnë zyrtarisht në AZHBR, listën e plotë të pronarëve të ullishteve të trajtuara.

B. Verifikimi dhe pagesa

AZHBR brenda 10 ditëve pune, nga marrja e njoftimit për përfundim të procesit të trajtimit bënë verifikim në vend të punës së kryer.

Për verifikimin e realizimit të procesit të trajtimit dhe plotësimin e dokumentacionit për financim,

ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve realizohet nga AZHBR-Qendër dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Grupi i verifikimit plotëson formularin e verifikimit (formulari 8/8). Formulari i verifikimit duhet të shoqërohet me listën e plotë të pronarëve të ullishteve të trajtuara dhe i dërgon ato brenda 10 ditëve në AZHBR-Qendër.

AZHBR-Qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit, në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

9. Mbështetja e prodhimit të qumështit me 10 (dhjetë) lekë/litër për fermat blegtorale që dorëzojnë minimalisht 1,500 litra qumësht në muaj, por jo më shumë se 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për fermë në muaj. Paga të bëhet kundrejt sasive të qumështit të shitura me faturë tatimore.

9.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë, subjekte me status fizik ose juridik;

- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

b) Përfitojnë ato ferma që kanë lopë, dele/dhi të matrikulluara;

c) Regjistri i fermës së lopëve, dele/dhi, i firmosur dhe vulosur nga DB;

d) Ferma të jetë e pajisur me certifikatë veterinare për llojin e blegtorisë që mbarështon;

e) Paga kryhet kundrejt sasive të qumështit të deklaruar me autofaturë ose faturë tatimore, sipas statusit të aplikantit;

f) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

9.2 KRITERET KONKURRUESE

1. Numri i krerëve 60 pikë;

2. Mjelje e mekanizuar 10 pikë;

3. Statusi i aplikantit 15 pikë;

4. Fermere femër 5 pikë;

5. Fermer nën moshën 40 vjeç 5 pikë;

6. Zona më pak të avantazhuara 5 pikë;

TOTALI 100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Paga e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

9.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periodha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 2 maj – 30 maj 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 9/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike së aplikantit;

b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;

c) Regjistri i fermës (regjistri i fermës së lopëve/dele/dhi, i firmosur dhe i vulosur ose fotokopje e noterizuar);

d) Certifikata veterinare e tufës;

i) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 9/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 9/4). Një kopje të formularit 9/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 9/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kriterëve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR.

Në çdo DB, ngrihet "Komisioni i vlerësimit të aplikimeve", i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh, sipas formularit përkatës (formulari 9/5).

Numri i krerëve: Vlerësimin maksimal prej 60 pikë e përfitojnë fermat, për jo më shumë se 100 krerë për lopët, dhe për fermat e bagëtisë së imët vlerësimin maksimal e përfiton ferma me numrin më të madh të krerëve.

Për statusin e aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- | | |
|---|----------|
| a) Aplikanti individual | 5 pikë; |
| b) Subjekte me status fizik ose juridik | 10 pikë; |
| c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor | 15 pikë. |

Për klasifikimin e zonave më pak të avantazuara, referohuni aneksit nr.5.

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR-së bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 9/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 9/7).

Të dy formularët (9/6 dhe 9/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR-së, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-

Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve në AZHBR rajonale bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuar. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR qendër.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-Qark organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij ligjor bën verifikimin në vend të kafshëve, sipas regjistrat të fermës dhe faktit dhe plotëson formularin e verifikimit (formulari 9/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitimit, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse gjendja faktike e fermës është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

-Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore” ose fotokopje të librezës së pensionit;

-Regjistrin e fermës të firmosur dhe të vulosur nga DB ose fotokopje e noterizuar;

Fermeri dorëzon tek inspektori i AZHBR-së, faturat e shitjes mujore të qumështit brenda javë së parë të muajit pasardhës. Fatura duhet të jetë:

1. Për subjektet, faturë tatimore e shitjes e shoqëruar me kuponin e kasës fiskale.
2. Për fermerët individualë, të dorëzohet autofatura.

Inspektorët plotësojnë formularin e marrjes në dorëzim të faturave (9/8/b), dhe bëjnë plotësimin e dosjes dhe e dorëzojnë në AZHBR-Qendër.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në drejtoritë përkatëse të AZHBR, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 9/9 dhe 9/9/a).

AZHBR-Qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit, në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumenteve të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë, dosja e skualifikuara në AZHBR-Qendër bëhet pranë inspektorit të riskut, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formulari 9/9/a).

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR-Qendër, sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR-së.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të numrit faktik të krerëve të deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i numrit të krerëve rezulton më i vogël se 5% për lopët dhe 10% për bagëtitë e imëta në mënyrë të pajustificuar, aplikuesi mbështetet financiarisht pa u penalizuar;

- Kur ndryshimi i numrit të krerëve është mbi 5% për lopët dhe mbi 10% për bagëtitë e imëta në mënyrë të pajustificuar, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogarit të mbështetjes financiare;

- Kur ndryshimi i numrit të krerëve është mbi 40% në mënyrë të pajustificuar, aplikanti skualifikohet

nga grupi i verifikimit në terren.

10. Mbështetja e fermave blegtorale që mbarështojnë në mënyrë ekstensive (regjim gjysmëstallor) lopë të matrikulluara në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por financimi të bëhet për jo më pak se 10 (dhjetë) krerë dhe jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë.

10.1 KRITERET E PËRFTITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

-Fermerë individualë, subjekte me status fizik ose juridik;

-Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor.

b) Përfitojnë fermat me jo më pak se 10 krerë lopë të matrikulluara, por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë lopë të matrikulluara;

c) Subjektet fizik, juridik dhe Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor duhet të jenë të regjistruar si subjekt në organet tatimore;

d) Përfitojnë ato ferma që kanë lopë të matrikulluara dhe me regjim gjysmëstallor;

e) Ferma të jetë e pajisur me certifikatë veterinare për lopët që mbarështon;

f) Përfituesi të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

10.2 KRITERET KONKURRUESE

1. Numri i krerëve 50 pikë;

2. Raca 25 pikë;

3. Statusi i aplikantit 15 pikë;

4. Aplikante femër 5 pikë;

5. Fermer nën moshën 40 vjeç 5 pikë;

TOTALI 100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

10.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 2 maj – 30 maj 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR, sipas formularit të aplikimit (formulari 10/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike të aplikantit;

b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;

c) Regjistri i fermës së lopëve, i firmosur dhe vulosur nga DB;

d) Certifikata veterinare e tufës;

e) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë;

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 10/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 10/4). Një kopje të formularit 10/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 10/4).

DB-ja grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kritereve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR-ja.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së - kryetar,
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër - anëtar.
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor - anëtar
4. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB-së - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh, sipas formularit përkatës (formulari 10/5).

Numri i krerëve: Vlerësimi maksimal për numrin e krerëve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të lopëve të matrikulluara në nivel rrethi, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin më të madh të lopëve.

Raca: Përsa i përket racës pikët maksimale (25), i marrin ferat me lopë të racave autoktone, 20 pikë marrin kryqëzimet;

Për statusin e aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- | | |
|---|----------|
| a) Aplikanti individual | 5 pikë; |
| b) Subjekte me status fizik ose juridik | 10 pikë; |
| c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor | 15 pikë. |

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 10/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 10/7).

Të dy formularët (10/6 dhe 10/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në

dispozicion, AZHBR-Qark organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohen nga AZHBR dhe miratohet nga drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij ligjor bën verifikimin në vend të kafshëve, sipas regjistrimit të fermës dhe faktit dhe plotëson formularin e verifikimit (formulari 10/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitimit, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse gjendja faktike e fermës është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 10/8) në AZHBR.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 10/9 dhe 10/9/a).

AZHBR-ja, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit, bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë së skemës mbështetëse.

Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumenteve të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë aplikimi skualifikohet dhe dosja arkivohet.

- Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të numrit të krerëve, në raport me numrin e krerëve të deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i numrit të krerëve rezulton deri në 10%, aplikuesi mbështetet pa u penalizuar;
- Kur ndryshimi i numrit të krerëve është mbi 10%, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të mbështetjes financiare;

Kur ndryshimi i i numrit të krerëve është mbi 40%, aplikanti skualifikohet.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR-Qendër, sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR.

Nëse në projektet e kontrolluara pas financimit ka ndryshime të parametrave sasiore të cilat ndikojnë në vlerën financiare që përfituesi ka përfituar padrejtësisht, AZHBR-ja bën rillogaritjet dhe propozon masat përkatëse.

11. Mbështetja e fermave blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele ose dhi të matrikulluara, në vlerën 1,200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 300 (treqind) krerë.

11.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë, subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

b) Subjektet fizike, juridike dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor duhet të jenë të regjistruar si

subjekt në organet tatimore;

- c) Fermerë që kanë tufa homogjene me dele ose me dhi të matrikulluara;
- d) Madhësia e tufës sipas përcaktimeve të mësipërme jo më pak se 100 krerë dele ose dhi të matrikulluara, por financimi të kryhet për jo më shumë se 300 krerë dele/dhi të matrikulluara;
- e) Tufat të jenë të pajisura me certifikatë veterinare;
- f) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

11.2 KRITERET KONKURRUESE

- | | |
|--|-----------|
| 1. Numri i krerëve dele/dhi të matrikulluara | 65 pikë |
| 2. Raca | 10 pikë; |
| 3. Statusi aplikantit | 15 pikë; |
| 4. Aplikante femër | 5 pikë; |
| 5. Aplikantët nën moshën 40 vjeç | 5 pikë; |
| TOTALI | 100 pikë. |

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

11.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 2 maj deri më 30 maj 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR, sipas formularit të aplikimit (formulari 11/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike e aplikantit;
- b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;
- c) Regjistri i fermës i deleve/dhive të matrikulluara, i firmosur dhe vulosur nga DB;
- d) Certifikata veterinare e tufës së deleve/dhive;
- e) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimi (formulari 11/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (formulari 11/4). Një kopje të formularit 11/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (formulari 11/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kriterëve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR-ja.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

- 1. Drejtori i DB-së – kryetar;
- 2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
- 3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
- 4. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit

të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (formulari 11/5).

Numri i krerëve: Vlerësimi maksimal për numrin e krerëve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të deleve/dhive të matrikulluara, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin maksimal të krerëve.

Raca: Pikët maksimale 10, i marrin feramat me dele/dhi të racave të pastra dhe 5 pikë kryqëzimet.

Statusi i aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- a) Aplikanti individual 5 pikë;
- b) Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë;
- c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor 15 pikë;

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR-së bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion, ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 11/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 11/7).

Të dy formularët (11/6 dhe 11/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB-së, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-Qark organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij ligjor bën verifikimin në vend të kafshëve, sipas regjistrat të fermës dhe faktit dhe plotëson formularin e verifikimit (formulari 11/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitimit, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse gjendja faktike e fermës është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit, aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 11/8) në AZHBR.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 11/9 dhe 11/9/a).

AZHBR-ja, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit, bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të numrit të krerëve, në raport me numrin e deleve/dhive të matrikulluara deklaruar në aplikim, AZHBR-ja aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i numrit të krerëve rezulton më i vogël se 10%, aplikuesi mbështetet për numrin faktik të krerëve, pa u penalizuar;

- Kur ndryshimi i numrit të krerëve është mbi 10%, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të mbështetjes financiare;

- Kur ndryshimi i numrit të krerëve është mbi 40%, aplikanti skualifikohet.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme.

Nëse në projektet e kontrolluara pas financimit ka ndryshime të parametrave sasiore të cilat ndikojnë në vlerën financiare që përfituesi ka përfituar padrejtësisht, AZHBR-ja bën rillogaritjet dhe propozon masat përkatëse.

12. Mbështetja e mishit të të imtave, në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë të matrikulluar, për çdo therje në thertore, dhe 100 (njëqind) lekë, për lëkurën e dorëzuar në fabrikën e përpunimit në vend.

13. Mbështetja e mishit të derrit, në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë të matrikulluar, për çdo therje në thertore, dhe 100 (njëqind) lekë, për lëkurën e dorëzuar në fabrikën e përpunimit në vend.

14. Mbështetja e mishit të gjedhit, në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë/krerë të matrikulluar, për çdo therje në thertore, dhe 200 (dyqind) lekë, për lëkurën e dorëzuar në fabrikën e përpunimit në vend.

PROCEDURA PËR SKEMAT E MBËSHTETJES SË MISHIT

1. KRITERET E PËRFTIMIT (Skemat 12/13/14)

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

-Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;

-Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

b) Fermerë/fermat blegtorale, që rrisin të imta, derra dhe gjedh të matrikulluar;

c) Ferma të jetë e pajisur me certifikatë veterinarë;

d) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”;

e) Financimi bëhet për kafshët e therura për mish, në thertore të licencuara (të pajisura me QKL), për: të imtat mbi pesë muaj, derrat mbi gjashtë muaj; gjedhi mbi shtatë muaj.

2. KRITERET KONKURRUESE (skemat 12/13/14)

1. Numri i krerëve të matrikulluara që parashikohen për dorëzim mishi 65 pikë;

2. Statusi i aplikantit 15 pikë;

3. Aplikante femër 10 pikë;

4. Fermer nën moshën 40 vjeç 10 pikë;

TOTALI 100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

3. PROCEDURA QË DO TË NDIQET (skemat 12/13/14)

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 2 maj deri më 30 maj 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 12,13,14/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike së aplikantit;
- b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;
- c) Certifikata veterinare e fermës;
- d) Regjistri i fermës, i firmosur dhe vulosur nga DB;
- e) Parashikim të numrit të krerëve për thertore (me vetëdeklarim);
- f) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë me firmë dhe vulë të njomë.

Aplikimi, së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimi (formulari 12,13,14/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimi për rrethin (formulari 12,13,14/4). Një kopje të formularit 12,13,14/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimi për rrethin (formulari 12,13,14/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kritereve të konkurrueshmërisë së skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR-ja.

Në çdo DB, ngrihet "Komisioni i vlerësimit të aplikimeve", i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar.
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër - anëtar.
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar.
4. Dy specialistë të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB-së - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (formulari 12,13,14/5).

Numri i krerëve: Vlerësimi maksimal për numrin e krerëve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të kafshëve të planifikuara për thertore, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin më të madh.

Statusi i aplikantit. Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- | | |
|---|----------|
| a) Aplikanti individual | 5 pikë; |
| b) Subjekte me status fizik ose juridik | 10 pikë; |
| c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor | 15 pikë. |

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR-së bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 12,13,14/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 12,13,14/7).

Të dy formularët (12,13,14/6 dhe 12,13,14/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-Qark organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga drejtori i AZHBR.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij ligjor bën verifikimin në vend të kafshëve të matrikulluara, sipas regjistrin të fermës dhe faktit dhe plotëson formularin e verifikimit (formulari 12,13,14/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitimit, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse gjendja faktike e fermës është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit, aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore” ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit;
- Regjistri i fermës së kafshëve, të firmosur dhe vulosur nga DB-ja.

Aplikanti dorëzon tek inspektori i AZHBR-së, faturat e shërbimit të therjes mujore të kafshës dhe/ose faturën e dorëzimit të lëkurës në pikat e përpunimit, brenda javës së parë të muajit pasardhës. Fatura duhet të jetë:

1. Për subjektet, faturë tatimore e shitjes e shoqëruar me kuponin e kasës fiskale.
2. Për fermerët individual, të dorëzohet autofatura.

Inspektori plotëson akt verifikimin (12,13,14/8) dhe merr vërtetimin e sigurimeve shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit.

Inspektorët plotësojnë formularin e marrjes në dorëzim të faturave (12,13,14/8/b), me dorëzimin e faturave për fazën e verifikimit inspektori i AZHBR, plotëson dosjen.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në AZHBR- Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 12,13,14/9).

Dorëzimi i dosjeve të skualifikuara bëhet pranë inspektorit të riskut në AZHBR-Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formulari 12,13,14/9/a).

AZHBR-Qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse. Në rast të mospërputhshmërisë së parametrave apo dokumenteve të caktuara me kushtet e përfitueshmërisë e dërgon aplikimin e refuzuar në DPAP.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR.

15. Mbështetja për bletërritësit me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere bletë, në vlerën 1,000 (një mijë) lekë/koshere.

15.1 KRITERET E PËRFITIMIT

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermër individualë, subjekte me status fizik ose juridik;
 - Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;
- b) Subjektet fizik, juridik dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor duhet të jenë të regjistruar si subjekt në organet tatimore;
- c) Aplikantët me jo më pak se 50 koshere blete;
- d) Të ketë aktivitet të identifikueshëm nga DB-ja;

e) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

15.2. KRITERET KONKURRUESE

- | | |
|--------------------------------|-----------|
| 1. Numri i koshereve | 75 pikë; |
| 2. Statusi i aplikantit | 15 pikë; |
| 3. Aplikante femër | 5 pikë; |
| 4. Aplikant nën moshën 40 vjeç | 5 pikë; |
| TOTALI | 100 pikë; |

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Paga e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

15.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periodha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 2 maj - 15 qershor 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 15/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike e aplikantit;
- b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;
- c) Vërtetimin nga DB-ja ku vërtetohet aktiviteti dhe numri i koshereve që disponon;
- d) Certifikata veterinare e bletëve;
- e) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë, me firmë dhe vulë të njomë.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 15/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 15/4). Një kopje të formularit 15/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 15/4).

DB-ja grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kriterëve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialist të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh, sipas formularit përkatës (formulari 15/5).

Numri i koshereve: Vlerësimi maksimal për numrin e koshereve e fiton aplikuesi me numrin më të madh të koshereve të aplikuara, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me numrin më të madh të koshereve të aplikuara.

Statusi i aplikantit. Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- | | |
|---|----------|
| a) Aplikanti individual | 5 pikë; |
| b) Subjekte me status fizik ose juridik | 10 pikë; |
| c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor | 15 pikë. |

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion, ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 15/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 15/7).

Të dy formularët (15/6 dhe 15/7) firmosen nga përfaqësuesi i DB, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR-së, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja organizon verifikimin në terren të projekteve që ndodhen mbi vizën e financimit.

Me fillimin e procedurës së verifikimit, aplikanti është i detyruar të grumbullojë kosheret në një vend brenda qarkut në të cilën ka aplikuar, dhe të njoftojë përfaqësuesin e AZHBR-së për momentin dhe vendin e verifikimit.

Brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit grupi i verifikimit bën verifikimin në vend të aplikimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet "Grupi i verifikimit të projekteve", i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij ligjor, bën verifikimet dhe numërimet e nevojshme, markon kosheret e numëruara dhe plotëson formularin e verifikimit të aplikimit (formulari 15/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin, nëse aplikimi është në përputhje me udhëzimin dhe aplikimin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit, aplikanti duhet të paraqesë:

- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit.

Grupi i verifikimit, brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit, dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 15/8) në AZHBR-Qendër.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR-Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 15/9 dhe 15/9/a).

AZHBR-ja pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të numrit të koshereve, në raport me numrin e koshereve të deklaruara në aplikim, AZHBR-ja aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i numrit të koshereve rezulton deri në 10%, aplikuesi mbështetet për numrin faktit të koshereve, pa u penalizuar;

- Kur ndryshimi i numrit të koshereve është mbi 10%, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të mbështetjes financiare;

- Kur ndryshimi i numrit të koshereve në raport me deklarinë është mbi 40%, aplikanti skualifikohet.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit, sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme.

Nëse në projektet e kontrolluara pas financimit ka ndryshime të parametrave sasiore, të cilat ndikojnë në vlerën financiare që përfituesi ka përfituar padrejtësisht, AZHBR-ja bën rillogaritjet dhe propozon masat përkatëse.

16. Mbarështimi intensiv i kërmillit, në masën 50% të vlerës së rasatit deri 500 (pesëqind) kg/ha, por jo më shumë se 500,000 (pesëqind mijë) lekë/ha. Kjo mbështetje të jetë për ata që fillojnë investimin për mbarështimin e kërmillit për herë të parë. Për mbarështuesit, që e kanë bërë investimin fillestar më parë, të mbështeten fermat që bëjnë mbarështimin intensiv të kërmillit, me një

vlerë 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

16.1 KRITERET E PËRFITIMIT

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:
 - Fermerë individualë, subjekte me status fizik ose juridik;
- b) Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;
- c) Fletë analize për sasinë e Ca në tokën ku do të kultivohet kërmilli;
- d) Të ketë certifikatë veterinare;
- e) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

16.2 KRITERET KONKURRUESE

1. Madhësia e fermës	45 pikë;
2. Teknologjia e kultivimit	20 pikë;
3. Statusi i aplikantit	15 pikë;
4. Plan biznesi	10 pikë;
5. Aplikante femër	5 pikë;
6. Aplikant nën moshën 40 vjeç	5 pikë;
TOTALI	100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

16.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 2 maj – 16 qershor 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së sipas formularit të aplikimit (formulari 16/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike të aplikantit;
- b) Dokument që vërteton statusin e aplikantit;
- c) Projektin e plotë, i cili duhet të përmbajë këto elemente:
 - Teknologjia e kultivimit;
 - Kostoja e projektit të kultivimit me zëra dhe elemente;
 - Sasia e prodhimit;
 - Të ardhurat nga shitja;
- d) Certifikata veterinare;
- e) Dokumenti i pronësisë/marrjes së tokës me qira;
- f) Pagesa e taksës së tokës për vitin 2014;
- g) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë, me firmë dhe vulë të njomë;

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtëm:

-Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

-Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

-Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- a) Kontratë qiraje me individë;
- b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip);

Kontrata e qirasë në të dyja rastet, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të

regjistrohet në regjistrin publik.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 16/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 16/4). Një kopje të formularit 16/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 16/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR-së, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve, i cili është përgjegjësi e DB-së, bëhet sipas kritereve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe monitorohet nga AZHBR-ja.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialistë të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (formulari 16/5).

Madhësia e fermës: Vlerësimi maksimal për madhësinë e fermës e fiton aplikuesi me sipërfaqen më të madhe, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këtë sipërfaqe.

Teknologjia dhe plan biznesi vlerësohen në përmbajtjen e tyre.

Statusi i aplikantit. Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- | | |
|---|----------|
| a) Aplikanti individual | 5 pikë; |
| b) Subjekte me status fizik ose juridik | 10 pikë; |
| c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor | 15 pikë. |

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet ZBRR-së bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin, deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB në AZHBR-Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 16/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR-Qark (formulari 16/7).

Të dy formularët (16/6 dhe 16/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB-së, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHB-së bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuar. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-Qark organizon verifikimin në terren të projekteve, që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Menjëherë pas përfundimit të punës për zbatimin e projektit, fermeri njofton AZHBR në qark.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij bën verifikimin e investimit, matjet përkatëse dhe plotëson në vend formularin e verifikimit. (formulari 16/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitue-shmërisë dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit për aplikimet për ngritje investimi, aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën tatimore të blerjes së rasatit;
- Kontratë e shitjes së prodhimit ose faturat e shitjes së prodhimit (kur kemi më shumë se 1 vit aktivitet);

Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ose fotokopje e noterizuar e librezës së pensionit.

Grupi i verifikimit, brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit, dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 16/8) në AZHBR-Qendër.

Dorëzimet e dosjeve të verifikuara bëhen në AZHBR-Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 16/9 dhe 16/9/a).

AZHBR, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit, bën financimin e përfituesit në numrin e llogarisë.

Kur nga verifikimi në terren rezultojnë diferenca të sipërfaqes, në raport me sipërfaqen e deklaruar në aplikim, AZHBR aplikon penalitete, si më poshtë vijon:

- Kur ndryshimi i sipërfaqes rezulton deri në 10%, aplikuesi mbështetet për sipërfaqen faktike, pa u penalizuar;
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 10%, aplikanti penalizohet duke i zbritur 20% të vlerës së llogaritur të mbështetjes financiare;
- Kur ndryshimi i sipërfaqes është mbi 40%, aplikanti skualifikohet.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme.

Nëse në projektet e kontrolluara pas financimit ka ndryshime të parametrave sasiore, të cilat ndikojnë në vlerën financiare që përfituesi ka përfituar padrejtësisht, AZHBR-ja bën rillogaritjet dhe propozon masat përkatëse.

17. Mbështetja e sektorit të akuakulturës, në masën 25 % të vlerës së rasatit, por jo më shumë se 600 (gjashtëqind) mijë lekë/fermë dhe 25% të vlerës së ushqimeve për peshkun nën kultivim, por jo më shumë se 500 (pesëqind) mijë lekë/fermë, vërtetuar me faturë tatimore të shoqëruar me kuponin e kasës fiskale ose me urdhër xhirimi të bankës.

17.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë, subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

Aplikantë që zhvillojnë aktivitetin e tyre në akuakulturë, të cilët kultivojnë artificialisht këto produkte (mbështetje financiare për rasatin dhe ushqimet).

17.2 KRITERET KONKURRESE

1. Teknologjia e kultivimit	75 pikë;
2. Statusi i aplikantit	15 pikë;
3. Aplikante femra	5 pikë;
4. Aplikant nën moshën 40 vjeç	5 pikë;
TOTALI	100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

17.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periodha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 2 maj deri më 15 qershor 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së, sipas formularit të aplikimit (formulari 17/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së.

Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) Fotokopje e letërnjoftimit ose pasaportës biometrike e aplikantit;
- b) Dokumenti që vërteton statusin e aplikantit;
- c) Projekti, i cili të përmbajë:
 - Teknologjia e kultivimit;
 - Kostoja e projektit të kultivimit me zëra dhe elemente;
 - Sasia e prodhimit;
 - Të ardhurat nga shitja.

d) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Aplikimi, së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 17/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 17/4). Një kopje të formularit 17/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 17/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, bën vlerësimin formal të tyre dhe aplikimet me mangësi i kthen në ZBRR, për plotësim nga aplikanti brenda 5 ditëve pune.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas kriterëve të konkurrueshmërisë të skemës përkatëse dhe është

në përgjegjësi të DB-së dhe monitorohet nga AZHBR.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i vlerësimit të aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialistë të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Vlerësimi i projekteve bëhet vetëm një herë, brenda 10 ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dosjeve në DB. Vlerësimi bëhet me sistem pikësh sipas formularit përkatës (formulari 17/5).

Metoda e vlerësimit

Teknologjia e kultivimit: pikët maksimale 75 pikë i marrin feramat për mbarështimin e akuakulturës në vaska dhe kosha notues (intensive), 50 pikë marrin feramat e kultivimit të akuakulturës në mbarështimin ekstensiv.

Statusi i aplikantit. Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

- Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë;
- Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor 15 pikë.

Brenda 5 ditëve pune pas vlerësimit, DB-të bëjnë renditjen e projekteve për çdo skemë dhe rreth, sipas rendit zbritës të pikëve dhe nëpërmjet, ZBRR bëjnë shpalljen e listave të projekteve të vlerësuara me pikë në vende publike.

Një kopje e kësaj liste me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e vlerësuara dhe të renditura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion, ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-në Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 17/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR Qark (formulari 17/7).

Të dy formularët (17/6 dhe 17/7), firmosen nga përfaqësuesi i DB-së, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR-së, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR-së bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve në listat e vlerësimit të rrethit dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-Qark organizon verifikimin në terren të projekteve, që ndodhen mbi vizën e financimit.

Për verifikimin e realizimit të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist i fushës, përfaqësues i DB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR-ja dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Menjëherë pas përfundimit të punës për zbatimin e projektit, fermeri njofton AZHBR-në në

qark.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij bën verifikimin e investimit, matjet përkatëse dhe plotëson në vend formularin e verifikimit. (formulari 17/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitueshmërisë dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo, faktin nëse projekti i zbatuar nga fermeri është në përputhje me udhëzimin dhe projektin e miratuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Në momentin e verifikimit, aplikanti duhet të paraqesë:

- Faturën tatimore të blerjes së rasatit dhe/ose ushqimit për akuakulturën;
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore për “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Grupi i verifikimit brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit në terren të projektit dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit në AZHBR-Qendër.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në AZHBR-Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 17/9).

Dorëzimi i dosjeve të skualifikuara bëhet pranë inspektorit të riskut në AZHBR-Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formulari 17/9/a).

AZHBR-Qendër pas kontrollit administrativ të dokumentacionit bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit, në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR-Qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR-së.

18. Mbështetja për dorëzimin e prodhimit të midhjeve në qendrat e grumbullimit dhe/përpunimit, në vlerën 10 (dhjetë) lekë/kg të dorëzuar (të shitur) e të vërtetuar me faturë tatimore, por financimi të bëhet për jo më pak se 200 (dyqind) kv dhe jo më shumë se 1 000 (një mijë) kv në vit.

18.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermerë individualë, subjekte me status fizik ose juridik;
- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

18.2 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetjen financiare fillon më 2 maj deri më 15 qershor 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten pranë ZBRR-së sipas formularit të aplikimit (formulari 18/1). Formularët e aplikimit tërhiqen pranë ZBRR-së. Së bashku me formularin e aplikimit dorëzohet edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Fotokopje e letërnjoftimit ose pasaportës biometrike e aplikantit;

b) Dokumenti që vërteton statusin e aplikant;

c) Projekti, i cili të përmbajë:

- Teknologjia e kultivimit;
- Kostoja e projektit të kultivimit me zëra dhe elemente;
- Sasia e prodhimit;
- Të ardhurat nga shitja.

d) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Aplikimi së bashku me dokumentacionin e mësipërm dorëzohet te përfaqësuesi i ZBRR-së, i cili bën kontrollin nga ana formale të aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës, vendos kodin e aplikantit në formularin e pranimit (formulari 18/3), dhe bën regjistrimin e aplikimit në regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 18/4). Një kopje të formularit 18/3 i jepet aplikuesit.

Aplikantëve, të cilëve nuk i pranohet aplikimi kanë të drejtë të ankohen me shkrim brenda 5 ditëve pune tek drejtori i DB-së, i cili duhet t'i japë zgjidhje problemit me shkrim (pranimin ose mospranimin e aplikimit), brenda 5 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së ankesës.

Brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit, ZBRR-ja i dorëzon aplikimet (dosjet komplet) në DB, duke i shoqëruar me regjistrin e pranimit për rrethin (formulari 18/4).

DB grumbullon listat e ZBRR-së dhe dosjet e aplikimit të fermerëve, në bazë të renditjes së aplikimeve sipas radhës “Kush vjen i pari, renditet i pari”.

B. Vlerësimi

Vlerësimi i projekteve bëhet sipas radhës “Kush vjen i pari, renditet i pari”. Vlerësimi është përgjegjësi e DB-së dhe monitorohet nga AZHBR-ja.

Në çdo DB, ngrihet “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve”, i cili përbëhet nga 5 vetë dhe konkretisht:

1. Drejtori i DB-së – kryetar;
2. Një përfaqësues i AZHBR-Qendër – anëtar;
3. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit këshillimor – anëtar;
4. Dy specialistë të fushës përkatëse të skemës që vlerësohet, përfaqësues të DB - anëtar.

Një kopje e listës së aplikantëve me firmat e komisionit të vlerësimit dhe vulë të njomë të DB-së, në çdo faqe, ku lidhet materiali, dërgohet në rrugë protokollare në AZHBR-Qendër.

Listat e përgatitura nga DB-të dërgohen në AZHBR-Qendër edhe në mënyrë elektronike në adresën dpap@azhbr.gov.al.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion, ZBRR-të njoftojnë fermerët që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e mbështetjes financiare.

Njëkohësisht me shpalljen e listave bëhet edhe transferimi i dokumentacionit të aplikantëve nga DB-të në AZHBR-në Qark. Dorëzimi bëhet në mënyrë protokollare, sipas renditjes së projekteve në listat e vlerësimit duke plotësuar formularin e dorëzimit të dosjes (formulari 18/6), dhe regjistrin e dorëzimit në AZHBR Qark (formulari 18/7).

Të dy formularët (18/6 dhe 18/7) firmosen nga përfaqësuesi i DB, në funksionin e dorëzuesit dhe nga përfaqësuesi i AZHBR-së, në funksionin e marrësit.

Dosjet me mangësi në dokumentacionin përkatës nuk merren në dorëzim nga ana e AZHBR-Qark. DB-të brenda 5 ditësh të përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, ridorëzojnë dosjet e kompletuara, në AZHBR-Qark.

C. Regjistrimi i aplikimeve në *data base*

Me kalimin e dosjeve tek inspektorët e AZHBR-së bëhet edhe hedhja në *data base* të aplikimeve të vlerësuara. Informacioni i plotësuar përcillet elektronikisht në AZHBR.

D. Verifikimi dhe pagesa

Në bazë të renditjes së aplikimeve sipas radhës “Kush vjen i pari, renditet i pari”, dhe në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-Qark organizon verifikimin në terren të aplikimeve që kanë fituar të drejtën e financimit.

Për verifikimin në terren të projekteve fituese dhe plotësimin e dokumentacionit për financim, në çdo rreth ngrihet “Grupi i verifikimit të projekteve”, i përbërë nga 2 inspektorë të AZHBR-së në qark dhe 1 specialist, përfaqësues i DRB-së të rrethit përkatës. Grupi i verifikimit të projekteve kryesohet nga AZHBR dhe miratohet nga drejtori i AZHBR-së.

Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të një përfaqësuesi të tij ligjor bën verifikimin në terren, vlerësimin e prodhimit të pritshëm duke e krahasuar me deklarin në projekt (plan biznes) dhe plotëson në vend formularin e verifikimit (formulari 18/8).

Nga ballafaqimi i faktit me kriteret e përfitue-shmërisë dhe parametrat e projektit në bazë të të cilit aplikimi është vlerësuar, grupi i verifikimit konfirmon ose jo faktin nëse gjendja në terren është në përputhje me udhëzimin dhe projektin për të cilin është vlerësuar.

Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit.

Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Aplikanti duhet të njoftojë inspektorët e AZHBR-së para përfundimit të mbledhjes së prodhimit.

Afati i fundit i dorëzimit të faturave është java e parë e muajit tetor 2014.

Pasi aplikanti dorëzon faturat tatimore, certifikatën veterinare dhe dokumentet e tjera të nevojshme, grupi i verifikimit brenda 10 ditëve dërgon dosjen e plotë të aplikimit (dokumentacionin origjinal), së bashku me formularin e verifikimit (formulari 18/8) dhe formulari i marrjes në dorëzimi të faturave (formulari 18/8/b) në AZHBR Qendër.

Dorëzimet e dosjeve bëhen në AZHBR Qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formularët 18/9).

Dorëzimi i dosjeve të skualifikuara bëhet pranë inspektorit të riskut në AZHBR qendër, duke e shoqëruar të gjithë dokumentacionin e mësipërm me formularët e dorëzimit të dosjeve (formulari 18/9/a).

AZHBR Qendër, pas kontrollit administrativ të dokumentacionit, bën xhirimin e parave në numrin e llogarisë së përfituesit, në rastet kur aplikimi është në përputhje me kushtet e përfitueshmërisë të skemës përkatëse.

E gjithë procedura e verifikimit monitorohet nga Drejtoria e Kontrollit të AZHBR Qendër sipas një procedure të miratuar në rregulloren e brendshme të AZHBR-së.

19. Mbështetja, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 7 (shtatë) vite radhazi, për kreditë deri në 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtme:

- Ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe bimëve medicinale;

- Mekanizimin e bujqësisë, blegtorisë dhe akuakulturës.

19.1 KRITERET E PËRFITIMIT

a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

- Fermërë individuale dhe subjekte me status fizik ose juridik;

- Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor.

b) Përfitojnë projektet për ndërtimin e magazinave për grumbullim, përpunim apo ruajtjen e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe bimëve medicinale;

c) Përfitojnë projektet për blerjen e linjave të reja për përpunim të produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës, bimëve medicinale;

d) Përfitojnë projektet për blerjen e dhomave të ruajtjes frigoriferike;

e) Përfitojnë projektet që kërkojnë të zëvendësojnë pjesërisht teknologjitë dhe linjat ekzistuese me blerjen e makinerive të reja për përpunimin e produkteve të mësipërme;

f) Përfitojnë projektet për blerje anijesh të reja peshkimi dhe rinovim të flotës ekzistuese;

g) Të ketë bërë “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”.

Shënim. Në rast se aplikohet për mekanikë bujqësore ose blegtorale, aplikanti duhet të kenë në

pronësi/përdorim/qira, mbi 1 ha tokë bujqësore të kultivuar, ose mbi 5 dynym serrë diellore ose me ngrohje teknike dhe fermerë me jo më pak se 10 krerë lopë qumështi, si dhe fermerë/individë që kryejnë shërbime për të tretë.

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

- Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

a) Kontratë qiraje me individë;

b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip);

Kontrata e qirasë në të dyja rastet, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

19.2 KRITERET KONKURRUESE

1. Biznesplan i detajuar për ecurinë financiare për 7 vitet në vazhdim të subjektit

që financohet; 40 pikë;

2. Pjesëmarrje me kapitalet e veta në investimin; 25 pikë;

3. Statusi i aplikantit 15 pikë;

4. Koha prej të cilës subjekti ushtron aktivitetin 10 pikë;

5. Subjekte që investojnë për mbylljen e ciklit të një produkti (filiera) 10 pikë;

TOTALI 100 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Pagesa e tyre do të bëhet sipas fondit në dispozicion, duke filluar nga aplikantët me pikë maksimale.

Vlerësohen maksimalisht subjektet që mbulojnë me kapitalet e tyre përqindjen më të lartë të investimit.

Statusi i aplikantit: Niveli i vlerësimit për këtë kriter do të jetë si më poshtë:

a) Aplikanti individual 5 pikë;

b) Subjekte me status fizik ose juridik 10 pikë;

c) Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor 15 pikë.

Do të ketë vlerësimin maksimal biznesplan i strukturuar në paraqitjen e të dhënave financiare të subjektit, planin e investimit dhe parashikimi në lidhje me sektorin dhe tregun.

Vlerësimi maksimal për kohën e aktivitetit e marrin subjektet, të cilat kanë qenë aktivë në 2 vitet e fundit.

Vlerësohen maksimalisht, subjektet që investojnë për mbylljen e ciklit të produktit (filiera).

Për aplikantët të vlerësuar me pikë të barabarta gjatë procesit të vlerësimit, renditja e tyre bëhet sipas parimit “Renditet i pari, kush aplikon i pari”.

19.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Aplikimi për subjekte fizik/juridik

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten nga data 2 maj deri më 10 qershor 2014.

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten në AZHBR-Qendër, sipas formularit të aplikimit.

AZHBR-ja plotëson formularin e pranimit. Një kopje e këtij formulari i jepet aplikuesit.

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim, subjekti aplikues duhet të dorëzojë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike e aplikantit;
- b) Dokumenti ligjor i shoqërisë person fizik/juridik apo SHBB;
- c) "Letter of intend/comfort" për financimin e projektit të lëshuar nga banka;
- d) Dokumenti nga regjistri i kredisë që konfirmon që aplikanti nuk ka borxh të keq me institucione të tjera financiare;
- e) Bisnesplanin e detajuar (minimum 7-vjeçar);
- f) Ofertën për makineritë, linjën e marrë në konsideratë nga banka gjatë shqyrtimit të kërkesës për kredi;
- g) Dokumentin e pronësisë për kolateralin e lënë garanci për kredinë e marrë (kontratë hipoteke për pasuritë e paluajtshme, kontratë e pengut për makineri dhe pajisje të lëna garanci ose dokumentin e pronësisë mbi pasuri të paluajtshme apo pengje që do të përdoren për kolateral);
- h) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me "shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore".

i) Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë, me firmë dhe më vulë të njomë.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje të jetë i noterizuar.

AZHBR-ja regjistron të gjitha kërkesat e paraqitura në regjistrin e aplikimit të AZHBR-së.

B. Vlerësimi

Me përfundimin e afatit të aplikimit dhe marrjen e kërkesave, brenda muajit qershor 2014, komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të paraqitura dhe përzgjedhjen e subjekteve/fermerëve fitues. AZHBR-ja mund të hapë fazave të tjera aplikimi, në rast të tepicës së fondit të buxhetit të shtetit për mbështetjen financiare në bujqësi.

"Komisioni i vlerësimit të aplikimeve" përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të AZHBR-së.

Komisioni i vlerësimit të aplikimeve bën vlerësimet e kërkesave të paraqitura me pikë, sipas kriterëve të konkurrueshmërisë.

Niveli maksimal i vlerësimit të jetë 100 pikë dhe fitues mund të jetë çdo projekt me të paktën 60 pikë.

Brenda 5 ditë pune pas vlerësimit, komisioni i vlerësimit bën renditjen e projekteve sipas rendit zbritës të pikëve, nga projektet me pikë maksimale deri të projektet me pikë minimale dhe me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së bën shpalljen e listave të projekteve fituese dhe jo fituese në vende publike.

Subjekti/fermeri i kualifikuar, dorëzon pranë AZHBR-së, kontratën e huas të lidhur me bankën apo fondacionin kreditues e cila në objektin e saj, duhet të ketë të përcaktuar saktë shumën dhe qëllimin e përdorimit për investimin në fushën përkatëse të parashikuar në biznesplanin e shpallur fitues nga komisioni i vlerësimit. Kontrata e huas dhe plani i amortizimit ose grafiku i shlyerjes kredisë duhet të jenë origjinale ose fotokopje e noterizuar.

Përfitues nga skema e subvencionit të normës së interesit mund të jenë edhe aplikantë të cilët janë kredituar nga sistemi bankar 5 vitet e fundit, por që nuk kanë përfutur nga kjo skemë.

Për të përfutur subvencionin e normës së interesit, disbursimi i shumës së kredisë në favor të subjektit huamarrës, duhet të bëhet nga huadhënësi gjatë vitit 2014 dhe jo më vonë se periudha e 3-mujorit të parë të vitit pasardhës.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe pasi subjekti i shpallur fitues të ketë dorëzuar

kontratën e huas me grafikun e shlyerjes së kredisë, AZHBR-ja nënshkruan akt-marrëveshjen me bankën/subjektin financiar jobankë, brenda vitit 2014.

Në vazhdim të procedurës, në përputhje me fondet në dispozicion, AZHBR-ja njofton subjektet/fermer që kanë fituar të drejtën e mbështetjes financiare për procedurat e tjera që duhet të ndjekin deri në përfitimin e normës së interesit.

C. Verifikimi dhe pagesa

Në përfundim të investimit, por jo më vonë se 6-mujori i parë i vitit pasardhës (brenda datës 30 qershor 2015) aplikanti paraqet pranë AZHBR-së, kërkesën për verifikimin dhe kontrollin e realizimit të projektit në terren sipas biznesplanit dhe ofertës të shpallur fitues.

Për verifikimin e realizimit të investimit dhe plotësimin e dokumentacionit për likuidim “Grupi i kontrollit” i përbërë nga 3 pjesëtarë nga drejtoria e kontrollit të AZHBR-së dhe sipas rastit me ekspertë të fushave përkatëse të sektorëve që mbështeten, verifikojnë në terren realizimin e projektit konform biznesplanit dhe ofertës përkatëse.

Grupi i verifikimit bën verifikimin në vend të investimit në prani të aplikantit dhe plotëson në vend formularin e verifikimit, i cili firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi ligjor dhe i gjithë grupi i verifikimit. Verifikimi në terren pasqyron ecurinë dhe vlerën e investimit të kryer në fakt dhe shoqërohet me foto të cilat dokumentojnë investimin e mësipërm në raportin e kontrollit të drejtorisë së kontrollit.

Për çdo rast, aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Grupi i verifikimit, brenda 10 ditëve nga përfundimi i verifikimit të projektit dërgon formularin e kontrollit dhe raportin përkatës në drejtorinë e ekzekutimit të pagesave.

AZHBR-ja, pas verifikimit të procedurave të ndjekura nëpër të cilat kalon aplikimi, bën xhirimin e shumës së normës së interesit të përlllogaritur nga huadhënësi, në favor të përfituesit në numrin e llogarisë të përcaktuar nga banka/subjekti financiar jobankë.

Me fondet e planifikuara të vitit 2014 do të financohen edhe subjektet e shpallur fitues në vitet 2011-2013, të cilat plotësojnë kriteret e përfitueshmërisë së normës së interesit për 5 vite radhazi.

AZHBR-ja harton manualin e procedurës, si dhe formularët standard për këtë skemë.

20. Mbështetja e investimeve deri në 50% të vlerës së projektit, por jo më shumë se 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë për një subjekt, për:

- a) ngritje ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit;
- b) linja për standardizim dhe/ose përpunim prodhimi;
- c) mekanikë bujqësore;
- d) hapje puseh, rezervuare për vaditje dhe lera.

20.1 KRITERET E PËRFITIMIT

- a) Përfitues të kësaj skeme mbështetëse mund të jenë:

-Fermerë individualë dhe subjekte me status fizik ose juridik;

-Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor;

- b) Mbështetja financiare jepet për aktivitetet dhe investimet e mëposhtme:

-Ngritje dhe/ose rikonstrukcion ambientesh për grumbullim, ruajtje të prodhimit bujqësor, blegtoral, mbarështimit të kafshëve, shpendëve, bimëve medicinale dhe akuakulturës;

-Linja për standardizim (paketim, mbushje, konservim, ambalazhim,etj.) dhe/ose përpunim, si dhe mjete të specializuara transporti të prodhimit bujqësor, blegtoral, mjaltit, të bimëve medicinale, akuakulturës;

-Mekanikë bujqësore; traktorë bujqësorë apo pajisje të tjera për manovrim në nivel ferme;

-Hapje puseh, rezervuarësh për vaditje dhe lera.

- c) Trualli që do të përdoret për ngritje/rikonstrukcion ambientesh për ruajtjen e prodhimit ose

për linja standardizimi e përpunimi dhe për hapje pusesh, rezervuarësh për vaditje dhe lera, të jetë në pronësi, në përdorim ose i marrë me qira (për jo më pak se 9 vjet nga momenti i aplikimit), në emër të subjektit aplikues;

d) Për ngritje/rikonstrukcion ambientesh për grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimit, apo për linja standardizimi dhe/ose përpunim prodhimi, të sigurohet leja e ndërtimit nga autoritetet përgjegjëse;

e) Aplikantët që aplikojnë për mekanikë bujqësore, hapje pusesh, rezervuarë për vaditje dhe ndërtim lerash duhet që të kenë në pronësi, në përdorim ose me qira (për jo më pak se 5 vjet nga momenti i aplikimit), jo më pak se 1 ha tokë bujqësore në bllok ose në rastin kur merren me aktivitet blegtoral, duhet të kenë jo më pak se 10 krerë gjedh ose 100 krerë të imta të matrikulluara;

f) Investimi për të cilin aplikanti është shpallur fitues, nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës;

g) Financimi do të kryhet vetëm për linja/pajisje dhe makineri të reja;

h) Aplikantët e kësaj skeme të kenë përmbushur detyrimet tatimore dhe të kenë shlyer sigurimet shoqërore korente;

i) Aplikantët nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR apo MBZHRAU;

20.2 KRITERE KONKURRUESE

Për ngritje ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit:

1. Vlera totale e investimit	40 pikë;
2. Lloji i investimit	30 pikë;
3. Numri i punonjësve	10 pikë;
4. Investime për mbylljen e ciklit të një produkti(filiera)	10 pikë;
5. Fermer femër ose nën moshën 40 vjeç	5 pikë;
6. Eksportet (bujqësi, blegtori, bimë medicinale dhe akuakulturë)	5 pikë;
TOTALI	100 pikë.

Shënim.

Vlera e investimit:

Mbi 30 mln lekë	40 pikë;
Nga 20-30 mln lekë	30 pikë;
Nga 10-20 mln lekë	20 pikë;
Nën 10 mln lekë	10 pikë.

Lloji i investimit:

a) ngritje ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit;

b) linja për standardizim dhe/ose përpunim prodhimi;

c) mekanikë bujqësore;

d) hapje pusesh, rezervuare për vaditje dhe lerash.

Projektet, të cilat përfshijnë zëra nga dy llojet e investimeve ("a" dhe "b"), përfitojnë pikët maksimale 30 pikë;

Projektet, të cilat aplikojnë për zëra që përfshihen në llojin e investimit (a ose b), përfitojnë 20 pikë;

Projektet, të cilat aplikojnë për llojin e investimit ("c" ose "d"), përfitojnë 10 pikë;

Numri i punonjësve:

Subjektet që kanë më shumë se 15 punonjës në momentin e aplikimit përfitojnë pikët maksimale prej 10 pikë; nga 5 deri 15 punonjës, përfitojnë 5 pikë.

Subjektet me më shumë se një anëtar, përfitojnë 5 pikë në vlerësim, nëse të paktën njëri prej anëtarëve është femër ose nën moshën 40 vjeç.

Pikët për numrin e punonjësve, përfitohen kundrejt vetëdeklaratës së firmosur dhe të vulosur nga përfaqësuesi ligjor.

Pikët për eksportet përfitohen përmes vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur.

20.3 PROCEDURA QË DO TË NDIQET

A. Aplikimi

Periodha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 2 maj deri më 30 maj 2014.

AZHBR-ja mund të hapë fazave të tjera aplikimi, në rast të tepricës së fondit të buxhetit të shtetit për mbështetjen financiare në bujqësi.

Aplikimet për mbështetje financiare për këtë skemë paraqiten në AZHBR-Qendër.

Bashkëngjitur me kërkesën për aplikim, sipas llojit të investimit, aplikanti duhet të dorëzojë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikantit apo përfaqësuesit ligjor;
- b) Ekstraktin e regjistrimit në QKR për subjektet fizikë dhe juridikë;
- c) Dokumenti i noterizuar i dakordësisë së anëtarëve të SHBB-së apo ortakëve të subjektit, për objektin që aplikon;

d) Për dokumentin e pronësisë, përdorimit ose marrjes me qira të tokës, pranohet një nga dokumentet e mëposhtëm:

- Certifikata e pronësisë ose vërtetim pronësie (ZRPP), të shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i pronësisë së tokës sipas ligjit nr. 7501, vetëm kur akti i pronësisë është në emër të aplikantit;

- Vërtetim nga komuna/bashkia për tokën në përdorim.

Kur aplikanti merr tokë me qira:

- a) Kontratë qiraje me individë;
- b) Kontratë qiraje me komunat (kontratë tip);

Kontrata e qirasë në të dyja rastet bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826-840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

a) Fotokopje të regjistrit të fermës dhe certifikata veterinare e kafshëve (në rastin e aplikimeve me drejtim blegtoral);

b) Biznesplani i detajuar për 3 vjet;

c) Aplikanti duhet të paraqesë 3 oferta për çdo lloj investimi;

d) Vërtetim banke për numrin e llogarisë bankare, të firmosur dhe të vulosur;

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje, të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit.

AZHBR-ja bën vlerësimin nga ana formale të aplikimeve së bashku me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit. Një kopje e këtij formulari i jepet aplikantit.

AZHBR Qendër, me mbarimin e afatit të aplikimit dhe marrjen e kërkesave, bën vlerësimin e kërkesave të paraqitura dhe përzgjedhjen e aplikimeve fituese.

Mangësi serioze, të cilat sjellin skualifikimin e aplikimit janë:

1. Aplikimet e dorëzuara pas përfundimit të periudhës së aplikimit;
2. Mungesa e pjesës përshkuese dhe financiare të planit të biznesit, sipas modelit standard;
3. Mungesa e tri ofertave;
4. Mungesa e projektit dhe/ose preventivit (në rastin e ndërtimeve).

Aplikantët informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit, dhe do tu lihet një afat 10 - ditë për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR. Dorëzimi i dokumenteve pjesorë apo përtej afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi.

“Komisionet e vlerësimit dhe miratimit të aplikimeve” ngrihen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së, dhe përbëhen nga 5 përfaqësues të AZHBR-së.

Për zbatimin e kësaj skeme, AZHBR-ja harton manualin e procedurave.

Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së bëhet shpallja e listave të projekteve fituese në vende publike.

Pas procesit të vlerësimit, AZHBR-ja lidh kontratën me aplikuesin fitues.

Kushti i domosdoshëm për të përfituar mbështetjen nga skemat e buxhetit të shtetit është realizimi i investimit sipas kontratës dhe projektit bashkëngjitur aplikimit.

B. Kërkesa për financim

Sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet në raport me investimin e realizuar me maksimumi 2(dy) këste, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, sipas llojit të investimit, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore;
 - Lejen e ndërtimit të lëshuar nga autoritete përgjegjëse për investimet që kërkojnë leje ndërtimi;
 - Faturën/faturat tatimore të blerjes së linjave/mjeteve/pajisjeve, etj.;
 - Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me “shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore”, për vitin 2014;
 - Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.
- AZHBR-ja harton manualin e procedurës, si dhe formularët standard për këtë skemë.

KONTROLI PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT DHE ÇËSHTJE TË TJERA

1. AZHBR-ja është përgjegjëse për zbatimin, auditimin dhe likuidimin financiar të përfituesve sipas skemave të mbështetjes dhe kriterëve të përfitueshmërisë.

2. AZHBR-ja gëzon të drejtën për të kërkuar dokumentacion shtesë, në rast se e gjykon të arsyeshme.

3. MBZHRAU-ja dhe AZHBR-ja hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për skemat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për mbështetjen e prodhimit bujqësor.

4. Ndarjen e fondit të mbështetjes sipas rretheve e bën dhe/ose e ndryshon, kur është e nevojshme, Ministri i MBZHRAU, me propozim të AZHBR-së.

5. Grupet e verifikimit të projekteve ngrihen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së. Përfaqësuesit e DB-së në grupet e verifikimit propozohen nga drejtori i DB-së dhe miratohen nga drejtori i Përgjithshëm i AZHBR. Për arsye objektive mund të bëhen propozime dhe miratime për ndryshime në grupet e verifikimit. Grupet e verifikimit për skemat me kod 7,8,19 dhe 20 bëhen sipas procedurës së përcaktuar në secilën skemë.

6. DB-të janë përgjegjëse për procedurat e aplikimit, plotësimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të aplikimeve për fondin për mbështetjen e prodhimit bujqësor me përjashtim të skemave me kod 7,8,19 dhe 20. DB-të së bashku me listat e aplikantëve të kualifikuar duhet të dorëzojnë në mënyrë protokollare në AZHBR-Qendër, metodologjinë dhe pasqyrat e vlerësimit.

7. Hartuesit e projekteve nuk duhet të marrin pjesë në komisionet e vlerësimit dhe të verifikimit të projekteve. Anëtarët e komisioneve të vlerësimit të projekteve nuk mund të jenë anëtarë të grupeve të verifikimit të projekteve.

8. Në momentin e dorëzimit të dokumenteve të aplikimit në ZBRR, aplikantit i vendoset kodi i aplikantit. kodi i aplikantit formohet nga inicialet e qarkut dhe rrethit, numri i masës mbështetëse

dhe numri rendor i aplikantit, i cili korrespondon me numrin rendor në Regjistrin e pranimi të rrethit (formulari i/4).

9. Masat e mbështetjes kanë kodin e tyre. Ky kod ka formën: MBZHRAU_2014_01, ku dy shifrat e fundit tregojnë numrin e masës.

10. Mbështetja financiare për skemat numër 1, 9, 12,13,14, 16,17 mund të kryhet për faturat tatimore të lëshuara që nga 1 janar 2014.

11. Për çdo skemë, me urdhër të drejtorit të DB-së ngrihet grupi i vlerësimit, në çdo grup vlerësimi bën pjesë edhe një përfaqësues i AZHBR-Qendër, i cili përcaktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së.

12. Aplikuesit, të cilët nuk shpallen fitues nga komisionet e vlerësimit paraqesin ankesën e tyre brenda 5 ditëve nga shpallja e fituesve pranë DPPB-së të MBZHRAU, e cila brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës bënë verifikimin përkatës dhe i jep përgjigje ankimuesit.

13. DB-ja bënë afishimin në vende publike të listave të vlerësimit të konfirmuara nga AZHBR-Qendër.

14. I gjithë dokumentacioni që lidhet me vlerësimin dhe verifikimin e projekteve, i plotësuar pa korrigjime sipas formularëve bashkëngjitur këtij udhëzimi, i përcillen për administrim AZHBR-së.

15. Aplikanti përfiton të drejtën e financimit, kur ka zbatuar projektin për të cilën ka aplikuar dhe është shpallur fitues nga vlerësimi i projekteve. Në rastin kur zbatimi i projektit, për ndonjë arsye madhore, nuk është në përputhje me projektin e paraqitur për vlerësim, AZHBR-Qendër vendos për vazhdimësinë e procedurës deri në përfitimin ose jo të financimit.

16. Aplikantët të cilët kanë objeksione me vendimin e grupit të verifikimit kanë të drejtë të ankohen pranë drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së. Ankesa bëhet me shkrim në adresën: AZHBR, rruga “Muhamet Gjollësja”, nr.56, 1000, Tiranë. Ankesa mund të bëhet jo më vonë se 15 ditë nga data e verifikimit në vend të projektit. AZHBR-ja brenda 30 ditëve bënë verifikimet përkatëse dhe i kthen përgjigje aplikantit ankues.

17. Kur aplikimi skualifikohet gjatë kontrollit administrativ në AZHBR-Qendër, aplikanti njoftohet për arsyet e skualifikimit, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

18. AZHBR-ja është e detyruar që për një periudhë 10 - vjeçare të ruaj dosjen e plotë të dokumentacionit për çdo përfitues (dosja origjinale). Një kopje e dosjes së aplikantit ruhet në zyrat rajonale të AZHBR-së për të paktën 5 vjet.

19. Procedura e qarkullimit të dokumentacionit brenda drejtorive dhe sektorëve të AZHBR-Qendër përcaktohet në manualin e procedurës së çdo drejtorie.

20. DB-ja dhe AZHBR-ja raportojnë në mënyrë periodike për menaxhimin e fondit. MBZHRAU-ja nga ana e saj raporton çdo tremujor në MF për ecurinë e realizimit të programit të mbështetjes financiare.

21. Ministri i MBZHRAU-ja dhe ministri i MF-së, kur e gjykojnë të nevojshme, kërkojnë ngritjen e grupit të përbashkët të auditimit për të verifikuar administrimin e fondit.

22. Në rast se konstatohen shkelje të rregullave në administrimin e fondeve nga personat përgjegjës në DB apo AZHBR, merren masa disiplinore apo ç’dëmtim për çdo rast sipas dispozitave ligjore në fuqi.

23. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani